



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 62 AKTI

NR. 70 VENDIMI

Tiranë, më 16.10.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, më datë 12 tetor 2018, ora 10:00, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Adnan Xholi, prokuror/drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5, dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Suela Zhegu, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, me funksion prokuror/drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më datë 15 janar 2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues nr. 3, më datë 24.01.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues znj. Brunilda Bektoshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Prokuroria e Përgjithshme (PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Xholi”.

¹ Me shkresën nr. ***, datë 17.11.2017, dërgohet raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. ***, datë 30.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin. Mungesa e likuiditeteve të konstatuara është në atë masë, sa nuk ka cenuar besimin e publikut, si dhe ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Prokurorisë së Përgjithshme, nuk u gjet indice apo element që mund të ngrinte dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenonjë figurën e prokurorit”.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 19.06.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Adnan Xholi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe me rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 26.09.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, me rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, si dhe u ngarkua me barrën e provës për mungesën e likuiditeteve të konstatuara, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluara nga ana e Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me hetimin e kryer nga Komisioni, duke çmuar të njihet me dosjen, për të disponuar kopje të saj, si dhe për të paraqitur shpjegime/prova. Gjithashtu, z. Adnan Xholi, deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Adnan Xholi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të

³Me shkresën nr. ***, prot, datë 04.04.2018, dërgohet raporti i Prokurorisë së Përgjithshme.

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, me funksion prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ i thelluar, i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

Ky hetim u përqendrua mbi të gjitha te pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, konkretisht:

1. Apartament, me sipërfaqe 107 m², me vlerë 50,000 (*pesëdhjetë mijë*) euro, i cili ndodhet në qytetin e Tiranës, në rrugën “***”, i prenotuar për t’u blerë në vitin 2004. Pjesa në përqindje: 100 %.
2. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2004, me vlerë 4,000 (*katër mijë*) euro. Pjesa në përqindje: 100%.
3. Llogari e hapur më datë 07.12.2005, pranë “Alpha Bank”, në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, e cila ka shërbyer për lëvrimin e kredisë për blerjen e apartamentit në Tiranë. Vlera e deklaruar: 6,290 lekë. Pjesa në përqindje: 50 %.

4. Gjendje në “Credins Bank”, në vlerën prej 807,873 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %.
5. Gjendje në “Raiffeisen Bank”, në vlerën prej 258,410 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %.
6. Gjendje e llogarisë në “BKT”, më datë 31.12.2016, në vlerën prej 212,389 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %.
7. Gjendje *cash*, më datë 31.12.2016, në vlerën prej 800,000 lekësh. Pjesa në përqindje, 100%.

Pasuri të deklaruara veçmas nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit:

8. Gjendje llogarie në “Credins Bank”, më datë 31.12.2016, në vlerën prej 469,503 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %.
9. Tokë bujqësore e përfutur me AMTP, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, me sipërfaqe totale 22.126 m², e llojit “arë”, si edhe 430 m², në përdorim, ndodhur në Lushnjë. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaron se zotëron 1/8-tën pjesë.

Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua në:

- *Vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit;*
- *Burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.*

Lidhur me pasuritë e deklaruara, u vërejt se:

1. **Apartament**, me sipërfaqe 107 m², me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, i cili ndodhet në qytetin e Tiranës, Rr. “***”, sipas kontratës së porosisë të datës 28.10.2004. Pjesa në përqindje: 100 %.

Si burim i krijimit të kësaj pasurie⁴ subjekti deklaron se ka marrë kredi nga bankat e nivelit të dytë, ka marrë hua, si edhe diferencën e mbetur për lidhjen e kontratës së porosisë e ka përballuar me kursimet dhe të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Për likuidimin e kështit të parë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të mandatarkëtimit të datës 28.10.2004, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka derdhur në favor të shoqërisë “****” shumën prej 13,000 (trembëdhjetë mijë) USD ose 10,207 euro.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kontratën e huas, të datës 20.10.2004, sipas së cilës ai në cilësinë e huamarrësit ka marrë shumën prej 5,000 (pesë mijë) USD nga shtetasi B.S., me qëllim për të plotësuar kështin e parë të pagesës në favor të firmës ndërtuese “****” sh.p.k., për të lidhur kontratën e porosisë për blerjen e një apartamenti. Subjekti i rivlerësimit në DPV/2004 e ka deklaruar huan prej 5,000 USD ndaj shtetasit B.S.

⁴ Për këtë pasuri subjekti ka bashkëlidhur këto dokumente:

- Kontratë porosisë, e konfirmuar nga noteri publik, znj. L.K., me “Vërtetim nënshkrimi” me nr. *** rep., datë 28.10.2004.
- Kredi për blerje banese në “Alfa Bank”, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 01.12.2005, në shumën 5,000,000 lekë, me interes 8.6%, kësti mujor 63,000 lekë, me afat 15-vjeçar, disbursuar më datë 09.12.2005.
- Kopje të mandatarkëtimit të datës 28.10.2004, sipas të cilit shoqëria “****” ka arkëtuar shumën prej 13,000 USD ose 10,207 eurosh, të derdhura nga z. Adnan Xholi.
- Huamarrje pa interes për lidhjen e kontratës së porosisë, datë 28.10.2004, ndaj shtetasit B.S., deklaruar në vlerën prej 5,000 USD. Shlyer plotësisht përgjatë vitit 2005.
- Kontratë kredie lidhur me “Raiffeisen Bank”, nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 18.06.2006.

- ✓ *Lidhur me marrëdhënien e huasë, vlerësojmë se shpjegimet e dhëna dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duken bindëse dhe të mjaftueshme.*
- ✓ *Gjithashtu, nga analiza financiare rezulton se subjekti ka mundësi financiare për të plotësuar kryerjen e pagesës së plotë prej 13,000 (trembëdhjetë mijë) USD.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se, më datë 01.12.2005, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e kredimarrësve, kanë lidhur kontratën noteriale të kredisë me “Alpha Bank”.

Në vijim, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, nëpërmjet kontratës së kredisë bankare të datës 18.06.2006, lidhur me “Raiffeisen Bank”, kanë marrë kredi me kushte më të favorshme për të shlyer kredinë në “Alfa Bank”, në shumën prej 5,000,000 lekësh, për një afat 25-vjeçar, me interes 3 %.

Referuar deklaratës periodike vjetore të 2006-ës, subjekti i rivlerësimit në rubrikën “*Detyrime financiare ndaj personave fizikë juridikë*”, ka deklaruar kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, për blerje apartamenti. Sipas shënimit të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit, “Raiffeisen Bank” ka bërë blerjen e kredisë në “Alpha Bank”, pasi bëhet fjalë për të njëjtin apartament banimi.

Nga verifikimi i dokumentit “*Nxjerrje llogarie*” i “Alpha Bank”, i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, konstatohet se po më datë 28.08.2006, subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 4,950,000 lekësh, me qëllim mbylljen e kredisë në “Alpha Bank”.

Kredia në “Raiffeisen Bank” vazhdon të shlyhet nga subjekti i rivlerësimit dhe gjendja e mbetur e kredisë së marrë më datë 31.10.2016 është në shumën prej 3,372,696 (*tre milionë e treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë*) lekë.

- ✓ *Nga hetimi i kryer, ka rezultuar se nuk ka dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje.*

2. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2004, me vlerë 4,000 (katër mijë) euro. Pjesa në përqindje: 100 %. Blerë në vitin 2017.

Si burim i krijimit të kësaj pasurie⁵ subjekti deklaron se ka shërbyer shuma e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2018, konfirmon se nëpërmjet kontratës së shitjes të datës 18.01.2017, redaktuar nga noteri F.L., automjeti tip “Mercedes- Benz”, tipi E 270 CDI, me targë ***, është shitur nga subjekti i rivlerësimit për vlerën prej 4,000 eurosh. Ky mjet i është shitur shtetasit E.B.

⁵ Për këtë pasuri subjekti ka bashkëlidhur këto dokumente:

- Kontratë për shitje të mjetit me targa ***, me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 18.01.2017, me noter F.L.
- Kontratë për shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.01.2017, redaktuar nga noteri F.L.
- DPSHTRR me shkresën me nr. *** prot., datë 14.08.2018.

Nga ana e DPSHTRR-së konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, tipi 203, prodhim i vitit 2004, mjet i zhdoganuar, por i patarguar, në vlerën prej 4,000 eurosh. Në këtë kontratë parashikohet se blerësi deklaron se shuma për blerjen e këtij mjeti ka origjinë nga një shitje e mëparshme e një automjetit tip “Benz” me targë ***.

✓ *Trupi gjykues, nga hetimi i kryer ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga institucionet, si dhe nuk ngrihen dyshime lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.*

3. Likuiditete të subjektit të rivlerësimit, në emër të tij dhe bashkëshortes, sa më poshtë:

- Llogari e hapur më datë 07.12.2005, pranë “Alpha Bank”, në emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, për lëvrimin e kredisë për blerjen e apartamentit në Tirana. Vlera e deklaruar 6,290 lekë. Pjesa në përqindje: 50 %.
- Gjendje në “Credins Bank”, në vlerën prej 807,873 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %.
- Gjendje në “Raiffeisen Bank”, në vlerën prej 258,410 lekësh. Pjesa në përqindje: 100%.
- Gjendje e llogarisë në “BKT”, më datë 31.12.2016, në vlerën prej 212,389 lekësh. Pjesa në përqindje:100 %.
- Gjendja e llogarisë në “Credins Bank”, më datë 31.12.2016, në vlerën prej 469,503 lekësh, në emrin e bashkëshortes. Pjesa në përqindje: 100 %.
- Gjendje *cash* më datë 31.12.2016, në vlerën prej 800,000 lekësh. Pjesa në përqindje: 100 %. Si burim të krijimit subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe mësimdhënia.

Sa më sipër, si **burim për krijimin e likuiditeteve** subjekti ka deklaruar: të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes dhe të ardhurat nga mësimdhënia.

✓ *Trupi gjykues, nga hetimi i kryer ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga bankat, lidhur me gjendjen e llogarive bankare.*

Nga verifikimi i “deklaratave periodik/vjetore” në vite, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit në disa raste i paraqet kursimet e tij në mënyrë të pasaktë, duke i paraqitur likuiditetet në një vlerë të përbashkët (*cash + llogari bankare*).

Nisur nga të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vite, lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e tij dhe të personave të lidhur me të, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, u përpilua analiza financiare që reflekton situatën e subjektit ndër vite.

Komisioni, bazuar në analizën financiare ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë likuiditetesh të shtrira në vite për mbulimin e shpenzimeve të kryera, të deklaruar nga ai. Për këtë shkak, në rezultatet e hetimit subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Lidhur me rezultatet e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij, duke arsyetuar se në analizën financiare të bërë nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë: (1) kursimet e krijuara në fund të vitit 2003, të cilat paraqiten në shumën 920,000 lekë (duke paraqitur një analizë financiare të kryer nga një ekspert kontabël ku reflektoheshin të ardhurat dhe shpenzimet e kryera dhe duke vënë në dukje faktin se ai në këtë vit sapo kish lindur fëmijën e tij të parë dhe se shpenzimet familjare ishin më të ulëta se ato të reflektuara nga Komisioni);

(2) janë pasqyruar shpenzime për disa udhëtime, por ato në fakt rezultojnë udhëtime pune, të paguara nga institucioni përkatës, duke bashkëlidhur për secilin prej tyre dokumentacionin përkatës nga institucioni; (3) vizita jashtë shtetit të familjarëve të tij si vizitorë; (4) pagesa e kryer për këstin e kredisë nuk ka filluar në vitin 2005, por në vitin 2006 (*pra një vit më vonë*), e shoqëruar me dokumentacionin përkatës provues.

Ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se: *“Konstatimi i mungesës së likuiditetit ka si burim vitin e parë të deklaramit në 2003. Gjatë këtij viti hyri në fuqi për herë të parë dhe vetë ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, dhe subjektet e deklaramit nuk ishin të qarta se si duhet të bëheshin deklaramet si dhe mbi mënyrën e plotësimit të deklaratës. Gabimet dhe pasaktësitë lejoheshin në një masë të arsyeshme dhe zyrtari që mbarte detyrimin për deklaram nuk penalizohej”*.

Analiza e provave

Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe mori në konsideratë dokumentacion provues⁶ të paraqitur nga ai lidhur me:

- ❖ shpenzimet e udhëtimit për arsye zyrtare, mbështetur në dokumentacionin përkatës;
- ❖ shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit, si pedagog në Universiteti Ndërkombëtar, në Strugë, Maqedoni;
- ❖ shpenzimet si vizitor të familjarëve të tij jashtë shtetit (*të llogaritura në vlerën 20 euro/dita*);
- ❖ disa të ardhura shtesë nga pagat e tij dhe të bashkëshortës mbështetur në dokumentacion përkatës;
- ❖ u saktësua pagesa e këstit të kredisë në shumën prej 94,840 lekësh, e kryer në vitin 2006;

- të cilat u reflektuan në analizën financiare të Komisionit.

Në lidhje me deklaramet e subjektit të rivlerësimit për kursimet e krijuara deri në fund të vitit 2003, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë për të kursyer një shumë të caktuar, por ky kursim nuk është pasqyruar në deklaratën periodike përkatëse. Pavarësisht rezultateve të analizës financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ku provohet se ai ka pasur mundësi të kursente këtë shumë, trupi gjykues vendosi të mos e konsiderojë në analizën financiare të përditësuar të Komisionit.

Trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve përgjatë viteve, pas analizës financiare të përditësuar, nuk është në masën që cenon besimin e publikut. Ky përfundim arrihet pasi natyra e analizës financiare, e cila është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar

⁶ Dokumentacioni provues i dorëzuar në Komision nga subjekti i rivlerësimit:

- Vërtetim datë 13.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër për periudhën 1998 - 2004.
- Vërtetim me nr. *** prot., datë 26.09.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe tabela e të ardhurave nga paga për vitin 2007 në shumën prej 1,377,596 lekësh.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 20.01.2017, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2006 në shumën prej 217,976 lekësh, në vitin 2008 në shumën prej 301,697 lekësh.
- Kopje të praktikave për udhëtimet jashtë shtetit për arsye pune, ku pagesat janë përballuar nga institucioni.
- Shkresa nr. ***, datë 27.09.2018, e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
- Vërtetim me nr. *** prot., datë 20.01.2017, i “Raiffeisen Bank”, ku vërtetohet fakti i disbursimit të kredisë në shumën 5,000,000 lekë, më datë 25 gusht 2006.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 28.09.2018, nga Universiteti i Strugës, vërtetohet fakti i shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit si pedagog i jashtëm, janë përballuar nga ana e tyre.
- Dokumentacion bankar që vërteton se pagesa e këstit të kredisë në vlerën prej 94,840 lekësh është kryer në gusht 2006.

pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzioni për vlerësimin e pasurisë

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Xholi”*.

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Xholi, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzioni për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për sa i përket elementit të pastërtisë së figurës, për subjektin e rivlerësimit u konstatua se **është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës si prokuror.**

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, në periudhën 01.05.1998 - 31.12.1999, ka ushtruar funksionin e oficerit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Tepelenë; në periudhën 01.01.2000 - 31.12.2000 ka ushtruar funksionin e zv.prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës Parë Gjirokastrë; në periudhën 01.01.2001 - 05.01.2004 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit pranë Gjykatës Shkallës Parë Gjirokastrë; në periudhën janar 2004 - maj 2013 ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; në periudhën gusht 2012 - dhjetor 2012 ka qenë i komanduar si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; në periudhën nga qershori 2013 e **aktualisht ushtron funksionin prokurorit/drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme.**

Raporti për analizën e aftësive profesionale, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

- Formularin e vetëdeklarimit, 3 (tri) dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 (pesë) dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka konstatuar saktësinë e formularit të vetëdeklarimit, i plotësuar sipas udhëzimit të shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjetjet nga 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe 5 dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, zhvilluar në datën 11.01.2018 në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme, ku rezultoi se:

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Konstatohet se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Tregon aftësi në ndërthurjen e arsyesimit ligjor me situatën faktike. Formulon parashtrime dhe analiza të detajuara të kuptimit të dispozitave penale, objekt i referimeve përkatëse dhe trajtohen qartësisht dhe plotësisht lëndën, duke e përmbyllur me rekomandime të vlefshme për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të praktikës. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim (*shih dosjet nr. 1 dhe nr. 5*). Interpreton dhe zbaton drejt institutin procedural të kompetencës dhe juridiksionit.

Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyesimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përgjithësisht, përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në arsyetimin ligjor përdor teknikat e shkrimit dhe arsyesimit ligjor.

Të dhënat nga burimet arkivore

Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, të ketë pasur masa disiplinore.

Gjithashtu, raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme është bazuar duke iu referuar kritereve të vlerësimit, si:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

a) Lidhur me aftësitë profesionale

Z. Adnan Xholi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar në kategorinë “Shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij gjatë kryerjes së detyrës si prokuror.

Subjekti shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Në vendimmarrjet e tij, përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekti ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale dhe veprave penale të parashikuara në Kodin Penal. Po kështu, shfaq njohuri të plota dhe të admirueshme në drejtim të normave të Kodit të Procedurës Penale dhe metodikës së hetimit.

b) Lidhur me aftësitë organizative

Në dokumentet ligjore të përzgjedhura rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Kur subjekti ka pasur rolin e kontrollit të hetimeve, ka evidentuar me hollësi mangësitë e konstatuara në hetimet e kryera. Po kështu, ka lënë detyra të hollësishme në formë orientimesh për hetimet e mëtejshme, fakt që flet për një studim paraprak të thelluar dhe administrimin e çdo të dhëne të rëndësishme në aktet e procedimeve penale përkatëse.

c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, subjekti i rivlerësimit për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar “Shumë mirë” për etikën profesionale. Për subjektin nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar.

d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional, për subjektin e rivlerësimit nuk rezultojnë të dhëna konkrete mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë. Subjekti rezulton se për periudhën vlerësimit është angazhuar në shumë aktivitete profesionale.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua dhe në 4 denoncime, të paraqitura pranë Komisionit. Nga shqyrtimi i denoncimeve të ardhura, ka konstatuar se nuk ka indice për të provuar pretendimet e denoncuesve.

Nga ana e Komisionit, vlerësimi i aftësive profesionale u bazua në gjetjet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme në shpjegimet e dhëna nga subjekti, denoncimet e ardhura, si dhe në analizën e bërë, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk gjeta asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurorit, subjekt rivlerësimi, z. Adnan Xholi, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016 dhe propozoj për subjektin e rivlerësimit: **“I aftë”**.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit më datë 26.09.2018, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Adnan Xholi, në seancë dëgjimore në datën 12 tetor 2018, ora 10:00, në ambientet e godinës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnan Xholi, është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, më datë 26.09.2018, për të cilin ka komunikuar marrjen dijeni dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 12.10.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, i cili deklaroi se ishte dakord me gjithë hapat proceduralë të ndjekur nga trupi gjykues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit. Ai dha shpjegimet e tij dhe nuk paraqiti pretendime shtesë, duke kërkuar rikonfirmimin në detyrë.

IV. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të pranueshëm të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Xholi, me detyrë prokuror/drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 16.10.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda Bekteshi

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Valbona Sanxhaktari

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj